



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë më \_\_.\_\_.2024

**V E N D I M**

**Nr. 146, datë 19.03.2024**

**PËR**

**PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË, PËR POZICIONET E LIRA NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 244 DHE NR. 246, DATË 24.05.2023, PËR KANDIDATIN Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 19.03.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për tërheqjen e kandidatit z. {...} nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimin nr. 244 dhe nr. 246 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përparatur nga relatori z. Ridvan Hado, si dhe pasi shqyrtoi kërkesën e kandidatit për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, si dhe propozimin për përfundimin e kësaj procedure nga relatori i çështjes

**V Ë R E N**

**I. TË DHËNA PËR PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË**

1. Me Vendimin nr. 244, datë 24.05.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

*1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e të drejtës civile.*

2. Me Vendimin nr. 246, datë 24.05.2023 Këshilli, ka vendosur:

*1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e të drejtës civile.*

3. Në këto procedura të ngritjes në detyrë për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, afati i kandidimit është përcaktuar deri më datë 14.06.2023. Kjo procedurë është shoqëruar me njoftimin përkatës dhe publikimin e vendimeve respektive të shpalljes së vendeve të lira dhe hapjes së procedurës së ngritjes në detyrë në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

4. Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar edhe z. {...} (më poshtë referuar si kandidati), gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë<sup>1</sup>.

5. Këshilli, me vendimin nr. 57 datë 07.02.2024, ka vendosur:

*1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246 dhe nr. 247 datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 235, 236, 237 dhe 238 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

dhe pas shortit të hedhur

**2. Caktimin e relatorit si më poshtë:**

.... Për kandidatin z. {...} - z. Ridvan Hado.....

6. Më datë 12.02.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” i ndryshuar (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), në rrugë elektronike, kandidati u njoftua: i) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; ii) për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; iii) për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

---

<sup>1</sup> Aktualisht ushtron funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, i transferuar përkohësisht nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, me vendimin nr. 528, datë 11.10.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

7. Brenda afatit të përcaktuar kandidati nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

8. Më datë 19.02.2023, bazuar në pikën 8, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidatit iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

9. Brenda afatit, kandidati depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërsa një nga dokumentet, pikërisht formularin e deklaratës së pasurisë, sipas Vendimit 75/2019, kandidati duhet ta dorëzojë, jo më vonë se 21 ditë nga dita e dërgimit të tij, pra deri më datë 11.03.2024, pranë ILDKPKI-së.

10. Në vijim të procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ndër ta edhe për kandidatin z. {...}. Për këto kriterë ligjore kandidimi procedurat e verifikimit janë në proces e sipër.

11. Gjithashtu, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Shkresën nr. 1319 prot., datë 28.02.2024, i ka kërkuar Kolegjit të Posaqëm të Apelit trajtimin me përparësi të procedurës së rivlerësimit kalimtar ndaj kandidatit.

12. Me shkresën nr. 1321/2 prot., datë 28.02.2024 të Këshillit, për kandidatin z. {...} u kërkua informacion, për verifikimin e integritetit sipas Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, në kushtet kur ai është i vitlindjes më të hershme se Korrik 1977 (kandidati është i vitlindjes 1973), sikurse përcaktohet në pikën 8, Seksioni B, Kreu IX, të vendimit 75/2019.

**13. Në rrugë elektronike, me datë 11.03.2024, kandidati z. {...} ka parashtuar kërkesë për tërheqjen nga kandidimi për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 244 dhe nr. 246 datë 24.05.2023.**

14. Në rrethanat sa sipër, relatori përgatiti relacion bazuar në pikën 17, Seksioni B, Kreun VI, të Vendimit të Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve

dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), ku përcaktohet se: *“Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori i çështjes përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin mbi përfundimin e procedurës të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit”.*

15. Në Mbledhjen e datës 12.03.2024, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të rregullt procedurën e verifikimit paraprak të ndjekur për kandidatin z. {...}, si dhe po ashtu, si të qartë dhe të plotë vullnetin e shfaqur nga kandidati për t’u tërhequr nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 244 dhe nr. 246, datë 24.05.2023, bazuar në pikën 3, Seksioni C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për përfundimin e kësaj procedure ngritjeje në detyrë për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi.

## **II. SHQYRTIMI DHE VLERËSIMI I KËRKESËS SË KANDIDATIT PËR T’U TËRHEQUR NGA KANDIDIMI**

16. Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 136, pika 1 dhe 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, është organi kushtetues i ngarkuar, ndër të tjera, edhe me funksionin e propozimit Presidentit të Republikës të kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, pas ndjekjes së procedurave përkatëse sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin).

17. Këshilli në ushtrim të këtij funksioni, realizon procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit edhe për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, duke u mbështetur në Ligjin për Statusin, por edhe në Kodin e Procedurave Administrative, referuar për këtë në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar (më poshtë si Ligji për Qeverisjen). Sipas nenit 48 të Ligjit për Statusin, procedura administrative për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve fillon me kërkesën e tyre për shprehje të interesi. Kjo kërkesë, duke qenë një akt shprehje vullneti, mund të tërhiqet nga kandidati deri sa nuk ka një vendimmarrje nga organi kompetent, çka çon në përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për atë kandidat. E drejta e kandidatit për t’u tërhequr nga kandidimi, buron nga Kodi i Procedurave Administrative, neni 64, pika 2, sipas të cilit parashikohet se : *“Një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjore, përveç rasteve kur*

*kjo ndalohet me ligj. Ndryshimi apo tërheqja e kërkesës mund të kryhet në çdo kohë, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Pas tërheqjes së një pale, organi publik vendos përfundimin e procedurës administrative. Në këtë rast, organi publik njofton palët e tjera, nëse ka”. Nga ana tjetër, përfundimi i procedurës administrative për shkak të tërheqjes së kërkesës së palës përcaktohet në dispozitën e sipërcituar, por edhe në nenin 94, pika 1, të këtij Kodi, ku përcaktohet se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.*

18. Rregullimet ligjore si më lart janë reflektuar edhe në aktin nënligjor të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Vendimin 75/2019. Kështu, në Kreun V, Seksioni B, pika 6, të tij, përcaktohet se: *“Kandidati ka të drejtë të tërhiqet në çdo kohë nga kandidimi, duke e njoftuar me shkrim Këshillin. Pas këtij njoftimi, me propozim të relatorit të çështjes, përcjellë nga Komisioni, Këshilli vendos menjëherë përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit. Akti i Këshillit për përfundimin e procedurës së verifikimit, i njoftohet menjëherë kandidatit dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit”.*

19. Sa sipër, referuar fakteve të rezultuara gjatë procedurës së verifikimit, kandidati z. {...}, brenda afatit të kandidimit, ka paraqitur kërkesën për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet nr. 244 dhe nr. 246, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ndërkohë, gjatë zhvillimit të procedurës së ngritjes në detyrë, pikërisht të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit, ndërsa Këshilli ende nuk kishte marrë një vendim në lidhje me këtë, kandidati u tërhoq nga kandidimi në këtë procedurë ngritje në detyrë, duke parashtruar rregullisht përpara Këshillit kërkesë, në të cilën pasqyrohet në mënyrë të qartë dhe të plotë vullneti i tij për t’u tërhequr nga kandidimi.

### **III. KONKLUZIONE**

20. Në këto rrethana, pasur parasysh kuadrin ligjor në fuqi, ndërsa rezulton që kandidati z. {...} të ketë shfaqur në mënyrë të qartë dhe të plotë vullnetin e tij për t’u tërhequr nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 244 dhe nr. 246, datë 24.05.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se është vendi për të vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për këtë kandidat.

### **PËR KËTO ARSYE**

Mbështetur në pikën 2, të nenit 64, të Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 6, Seksioni B, Kreu V, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar, pasi shqyrtoi kërkesën e kandidatit për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 244 dhe nr. 246, datë 24.05.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

### **V E N D O S I :**

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet nr. 244 dhe nr. 246, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

### **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**